


3 - Diabeti gestacional

Diabeti gestacional përgjithësisht shfaqet në tremujorin e dytë ose të tretë të shtatzënisë dhe zhduket pas lindjes. Prek rreth 7-10% të grave shtatzëna dhe për të kontrolluar në mënyrë adekuate nivelet e sheqerit në gjak, është e nevojshme të ndryshohet stili i jetesës (ushqimi dhe aktiviteti fizik); nëse kjo nuk mjafton, është e nevojshme të prezantohet një terapi për të mbajtur nën kontroll nivelet e sheqerit në gjak. E vetmja terapi për diabetin e lejuar në shtatzëni është terapia me insulinë.


Cilat gra rrezikojnë më shumë



Gratë mbipeshë ose obeze përpara shtatzënisë; ato më të mëdha se 35 vjeç; ato që kanë njërin prind të prekur nga diabeti i tipit 2; ato me diabet gestacional në një shtatzëni të mëparshme.



Ato me glicemi esëll midis 100 dhe 125 mg/dl përpara shtatzënisë ose në javët e para të shtatzënisë; gratë që i përkasin etnive me risk të lartë të diabetit të tipit 2; ato që janë shtatzënë me binjakë.




Gratë që i janë nënshtruar fekondimit të asistuar; ato që gjatë shtatzënisë kanë shtuar shumë në peshë; ato fetusit i të cilave, gjatë kontrolleve me ekografi, rritet shumë.


Çfarë është diabeti gestacional




Duke nisur nga tremujori i II, placenta prodhon hormone që kundër veprojnë veprimin e insulinës dhe organizmi i nënës reagon duke prodhuar një sasi më të madhe.



Nëse sasia e insulinës së prodhuar nuk arrin të ekuilibrojë veprimin e hormoneve të placentës, niveli i sheqerit në gjak rritet dhe shfaqet diabeti gestacional.



Nëpërmjet placentës, sheqeri i nënës i kalon fetusit duke ndikuar në një rritje të tepërt të tij. Flitet për makrozomi nëse pesha e tyre në lindje është më e madhe se 4 kg.



Të lindësh fëmijë makrozomikë në mënyrë natyrale mund të jetë e vështirë dhe për këtë arsye ndonjëherë mund të jetë e nevojshme të kryhet prerja cezariene.



Në lindje këta fëmijë mund të shfaqin, më shpesh, hipoglicemi dhe shumë më rrallë, vështirësi në frymëmarrje apo verdhëz. Këto janë probleme kalimtare dhe parandalohen duke mbajtur nën kontroll me efektshmëri gliceminë gjatë gjithë shtatzënisë.



Diagnoza e diabetit gestacional është e rëndësishme edhe për nënën pasi kjo gjendje krijon kushtet paraprake për shfaqjen e hipertensionit arterial në shtatzëni dhe të Diabetit të Tipit 2 në vitet pas shtatzënisë.